



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 148 prot.

Shkodër me 23.03.2023



Lënda : Dërgim Vendimi.

Drejtuar: Prefekturës së Qarkut Shkodër

Arkivës së Këshillit të Qarkut

Mbeshtetur në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe Ligjin nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut” bashkëlidhur po Ju dërgojmë vendimin e Këshillit të Qarkut Shkodër:

Vendimin Nr. 05 Datë: 30.03.2023

Sekretare e Këshillit të Qarkut

Edita SHOSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr 148 Prot

Shkodër me 30.03 2023

V E N D I M

Nr. 05, Datë 30.03.2023

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2022 TË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2023, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 40, 41, 44, 77 shkronja dh, 78, pika 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 48 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 "Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Ligjin 155/2021 "Per Buxhetin e Vitit 2022", VKQ Shkoder nr.17, datë 30.12.2021 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022 dhe PBA Përfundimtare 2022-2024", diskutimit në komisionet përkatëse dhe pasi u diskutua në mbledhjen e kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër dt.21.03.2023, bazuar edhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13 dhe 15 i saj,

Pas relatimit nga Zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit, u kalua në procesin e votimit ku u miratua me **13 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim.**

V E N D O S I ;

1. Miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2022 dhe tabelat e realizimit të buxhetit, pjesë përbërëse të këtij vendimi, për ;
 - a) Raportin e shpenzimeve sipas programeve
 - b) Raportin e shpenzimeve të programeve sipas artikujve

- c) Projektet e investimeve me financim të brëndshëm.
- d) Treguesite ekonomike financiare.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi garkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Hilmi LAKTI

